

Koliqi's "romance"

Abstrakt: Devoted to "Shija e bukës së mbrûme" (1960) the only novel by Ernest Koliqi, the paper aims at analysing the structure, themes, motifs and the characters of such work, as well as the other textual and contextual signs in the novel.

One of the most prominent figures of Albanian literature, Ernest Koliqi synthetised in this novel Albanian cultural legacy with Albanian literature from the first half of the 20th century, making them unfold in a narrative discourse.

The novel, as the author himself defined it, is shaped as a "romance", imbued with little events from everyday life but which mirror wide literary theme-ideas such as the quest for the true love and identity or, the creation of authentic individual and national identity. Though composed in a classical form and written in a language rich in sayings, the author leads the reader into the world of his characters by exploring their problems, considering them as a clash amongst ideals and mindsets from the author's time, which is also the time when the novel was being written. The novel displays autobiographic and ideographic signs thus aiding the reader to understand and contemplate both characters and events to a deeper level.

Keywords: novel, structure, themes, ideas, narrative, literary form, autobiographic pact.

1. Hyrje

Ernest Koliqi është ndër të parët autorë që solli shenjat e modernitetit në letërsinë shqipe. Kësisoj, ai u bë ndër themeluesit e prozës moderne shqipe, prandaj tema edhe diskursi i tij lidhet me shenjat e modernitetit shqiptar. Koliqi, si njohës i letërsive dhe i shkollave letrare shqiptare, njohës dhe zbulues i kulturës tradicionale shqiptare, krijoi një model të ri letrar si në formë ashtu edhe në ide, duke i kombinuar këto dy premisa në një diskurs personal përmes semantikës dhe narracionit klasik metonimik. Koliqi mendoi se vepra letrare duhet të burojë nga trashëgimia etnike, pasi ngjarjet e vogla të përditshme janë brumë për tema të mëdha letrare. E nga këtu buron motivimi i tij për veprën letrare, duke e veshur me një

sensibilitet të ri dhe modern. Të gjitha këto elemente të përmendura këtu nuk do të kishin marrë formën e dëshiruar pa fokusimin kryesor të Koliqit në psikikën e personazhit për ta hetuar atë nga brenda, si zbulim e rrëfim që buron nga bota e letërsisë së tij. Koliqi i hetoi problemet individuale si më të rëndësishmet, duke i rrëfyer ato me një ndjeshmëri të re nëpërmjet formës dhe strukturës artistike romaneske. Prandaj, zgjedhja e tij për të trajtuar frymën e shpirtin shqiptar në një shije të re letrare, konsiderohet si shenjë e estetikës dhe e modernitetit.

2. Rromanxi

Shija e bukës së mbrûme (1960) është romani i vetëm i Ernest Koliqit, vepër e cila artikulon imagjinatën e autorit tonë në një formë më të gjatë dhe më ndryshe seç jemi mësuar ta shohim Koliqin – shkrimtar modern të formave të shkurtra. Mirëpo, mjafton t'i venerojmë vetëm shenjat nistore të librit, që të vërejmë Koliqin që e njohim, i cili ka sintetizuar të gjitha idetë e tij letrare nën një titull figurativ, siç është *Shija e bukës së mbrûme*, në një formë të burrërisë së pjekur (Llukaq, 1983, 68). Kjo rrugë dallohet që në paraqitjen që i bën librit, të cilin e nënshkruan me pseudonimin e njohur letrar *Hilush Vilza, H. V.* Por, ajo që tërheq vëmendjen mbi këtë formë të paraqitjes është mënyra e shfaqjes së H. V., i cili, përveç që përshkruan situatat në vepër, merr statusin edhe të komentuesit të saj, duke u përgjigjur në sqarime të ndryshme rreth problemeve të veprës. Kjo paraqitje e romanit, që në njëfarë mënyre përbën esencën, ka rëndësi tjetër për shkak se i paraprin lexuesit, që ky i fundit të krijojë përshtypje dhe të supozojë për një marrëveshje *autor-personazh-lexues*, madje një *pakt autobiografik* me lexuesin (*pacte autobiographique*) (Lejuene, 1975, 13), edhe pse në esencë është një fiksim përbrenda rrëfimit romanesk.

Përveç paraqitjes, që vjen si pasojë e sqarimit më të madh të problemit, Koliqi rrëfimin e vet synon ta projektojë më së miri përmes formës së *rromanxit*, si një roman i shkurtër, pasi që ka vendosur që ndodhinë ta artikulojë dhe ta reprezentojë përmes dashurisë së dy të rinjve. Që dashuria të realizohet me një *happy end*, Koliqi zgjedh *rromanxin*, sepse *rromanxjeri ka lë me perxie të vërteten me trillime, gjithësi t'i ketë ândja; mjaft qi t'ia pergjasë disi pûnës, e të ketë para sysh qellimin e naltë të rromanxit, qi s'âsht tjetër, veç me qitë në pah rrjedhët e zeza të vesit, e rrjedhët e mira të virtytit* (Rrota, 2006, 51).

Romani përbëhet nga njëzet e dy kapituj, në të cilët organizohet i gjithë rrëfimi autorial, një narracion klasik që ndërtohet duke kapërcyer nëpër kohë nën udhëheqjen e kujtimeve. Pra, gjithë struktura narrative e romanit është e ndërtuar në mënyrë klasike. Ndërsa *storja është si shtyllë kurrizore* (Forster, 2017, 27) themi që edhe autori ynë kapë storje që ekspozojnë situata momentale e monumentale shqiptare. Proza e Koliqit në përgjithësi

shquhet për ide të hapura, për forma jo të gjata e për plan narrativ të lirshëm. Kryesisht, të gjithë titujt e veprave letrare të Koliqit destinohen rrëfimin e ngjarjes, duke synuar gjithmonë zbërthimin e domethënies së titullit. Kështu që, duke qenë se *titulli i romanit është pjesë e tekstit – në fakt, është pjesa e parë që e ndeshim, dhe për këtë arsye ka fuqi mjaft të madhe të tërheqë dhe të përcaktojë vëmendjen e lexuesit* (Lodge, 2023, 255), edhe Koliqi ka bërë një gjetje ideale për ta përfaqësuar botën e tij letrare dhe autenticitetin alban përtej kufijve etnikë.

Titulli *Shija e bukës së mbrûme*, në një mënyrë shenjon temën në përgjithësi, duke dalë si koncentrat i idesë së autorit e shenjuar jetën e brendshme të autorit, sepse siç konstatojnë edhe teoricienët e romanit, *detyra e romansierit nuk është të tregojë ngjarje të mëdha, por të voglat t'i bëjë interesante* (Man, 2018, 24).

Autori rrëfen qartë, përmes veprimit të personazheve, me një idiomatikë tipike për shkollën, gjurmët e të cilëve kanë krijuar edhe para Koliqit *françeskanët e mdhaj*, siç i cilësonte At Zef Pllumi. Pra, gjuha dhe tema gjithmonë e kanë veçuar autorin, duke formuar kështu sistemin koliqian, i cili mbart në vete objektin *atdhe* dhe përpjekjen për t'i gjetur rrënjët e gjuhës dhe të kulturës shqiptare. Dashuria për atdheun dhe dëshira për të përçarur atë, jepen kësaj here nëpërmjet romanit si forma më e përsosur për të treguar çdo gjë, kuptohet përmes gjuhës si një sistem i përsosur, e që për Bahtin është *një sistem drejtëzash që priten* (Bahtin, 1980, 278).

Prandaj, *Shija e bukës së mbrûme* është vepër e ideve dhe idelogemave që kyqëzohen, në të cilën përshkrimi e rrëfimi shkrihen gjithherë për të dhënë sa më qartas idenë autoriale. Në këtë mënyrë, Koliqi shkon në hullinë teorike se, *me vetë fjalën roman idesh nënkuptohet denotimi i romanit ku idetë janë burim i energjisë së veprës, që krijojnë dhe ruajnë momentumin rrëfimtar, le të themi emocionet, zgjedhjet morale, marrëdhëniet personale ose mutacionet e fateve njerëzore* (Lodge, 2023, 261). Prandaj, romani i Koliqit, parë në këtë kontekst, në vete sintetizon idetë, momentumet narrative, emocionet, zgjedhjet etike, por edhe kodet personale dhe universale.

3. Struktura e strukturimi

Koliqi shquhet për strukturë komplekse prozaike dhe për strukturim linear fabulativ. Romani *Shija e bukës së mbrûme* është strukturuar në atë mënyrë, që autori të përcjellë emocionin, siç tha Lodge (ibid), por edhe pasionin e tij për artin, duke e strukturuar nëpër hapësirat tekstore, po edhe zgjedhur artin si *mjet komunikimi midis njerëzve, si mjet i cili bashkon ndjenjat e njëjta* (Tolstoj, 2023, 47).

Në këtë mënyrë, *kapitulli i parë* i romanit është bosht i përqendrimit, i cili rrëfen ngjarjen që ka ndodhur (analepsa) dhe që do të ndodhë (proleksa)

brenda një strukturimi. Me një fjalë, i tërë romani, e tërë ndodhia që jepet përmes personazheve, shkon drejt një destinimi të fabulës klasike të konstruktuar nga Koliqit. Autori ndjek një vijë, andaj themi se struktura, rrëfimi dhe përshkrimi bashkohen në një pikë, edhe pse përshkrimet e rrëfimet kalojnë shumë shpejt në tekst. Si tërësi, tekstin e përshkon një intrigë e dashurisë, një romancë, e cila, gjithashtu, udhëhiqet drejt realizimit të idesë koliqiane, e që në fund zgjidhet duke përfunduar drejt lumturisë, ashtu siç e do edhe forma e *rromanxit*.

Koliqi krijon botën fikzionale, duke bërë që të komunikojë me ambientin real, për të dhënë efekte dhe funksionim sa më të madh estetik dhe *si strukturë e gjerë i mundëson shkrimtarit një trajtë të tillë të shfaqjeje, jo vetëm një fragment të realitetit, por edhe një tablo komplekse të tij* (Todorov, 1995, 217). Kështu, shtresimet narrative thuren nëpërmjet intrigës së dashurisë e identitetit nacional, si strukturë që përfshin veprimet, dhe si strukturim që përfshin ngjarjet kryesore për të krijuar rrëfimin e plotë.

Narratori është ekstradiegetik, sepse është jashtë ngjarjeve, duke mos u përfshirë brenda rrëfimit, por duke qenë në një nivel më të lartë mbizotërimi. Prandaj, me pozicionin e tij të gjithëdijshëm bën që rrëfimi të jetë më i kompletuar dhe më i kontrolluar sa i përket aspektit artistik dhe atij perceptues, si dhe duke e bërë të mundur që të dalë në pah tërësia kuptimore përmes mjeteve dhe ideve artistike.

Element tjetër i rëndësishëm i Koliqit është aftësia e kombinimit të rrëfimit poetik, imazheve, situatave, ideve në mënyrë që të formojë një tërësi imagjinatave me ndërlidhje të fortë me realitetin dhe gjakimin e autorit. Këto së bashku krijojnë atë pamje që lexuesi të presë kënaqësinë e thjeshtë, duke e ditur pak a shumë fundin, mesazhin, megjithatë të papriturat shënjohen në tekst. Prandaj, ndërtimi i tillë, që ndjek konceptet klasike, bën edhe më të mundshëm që stili i Koliqit të jetë i rrjedhshëm dhe i hapur.

Aftësia kombinatorike e Koliqit ka të bëjë edhe me stilin e të rrëfyerit, sidomos në ato pjesë kur Koliqi do të jetë më i fortë emocionalisht, duke u afruar më shumë me personazhet, e veçanërisht me protagonistin, Jorgjin. Prandaj, ky ndryshim i distancave narrative bën që të karakterizohet si veçori esenciale e artit koliqian, që krijon një efekt estetik- dinamik në rrëfim. Në pjesë të veçanta të tekstit, sidomos kur fokusohet te Emin Dashi, personazhi autobiografik e autoideografik i tij, rrëfimi afrohet me pozicionin homodiegetik, sidomos kur do ta theksojë të vërtetën mbi ekzistencën e shqiptarëve në periudha të vështira kohore, e sidomos kur ato sundohet nga ideologjia e majtë, diktatura komuniste. Këtu Koliqi, edhe pse nuk del si pjesëmarrës i ngjarjeve, zëri i tij jehon si një dëshmitar i përjetimeve të personazheve, duke bërë që të prekë në thelb dhembjen universale të migrit, vrasjes nëpërmjet artit. Në këtë kontekst, themi

se strukturimi i romanit të Koliqit, përveç që ndërtohet nga elementet e narracionit që njihen në narratologji, shpërfaqet edhe si rrëfim paralel i elementeve estetike.

Duhet të theksojmë se, ky roman trajton fund e krye çështje dhe probleme shqiptare të kohës nëpërmjet lëvizjes mendore e kulturore që udhëhiqet nga Emin Dashi, si autor i programit të çlirimit të Shqipërisë. Preokupimi kryesor i krejt veprimtarisë së tij është çështja e atdheut të lirë, duke dalë në fokus edhe në këtë tekst, por tash në një formë më të gjatë dhe më hollë e shpjeguar. Rrëfimi bëhet duke pasur objekt linjën e rrëfimit të dashurisë midis dy personazheve, Jorgjit dhe Djanës, *sepse dashuria duhet të jetë subjekt kryesor i romanit* (Chartier, 2015, 90). Ritmi i rrëfimit të ky tekst është dinamik, por Koliqi ndalet në detaje, pra do të përqendrohet në situata e ngjarje tejet të vogla, sidomos të pikëpamjet atdhetare të të dy të dashuruarve. Në këtë aspekt, Koliqi përfundimisht është pas të gjitha ngjarjeve, e pas të gjithë personazheve, sikur për ta dhënë realitetin e jetës së tij, *sepse e vërteta është element i strukturës së veprës letrare dhe, njëherit, faktor themelor në relacion me lexuesin* (Bytor, 1980, 223).

Pasi që e gjithë struktura e romanit paraqitet si një botë e mbyllur dhe e drejtuar nga përvojat personale të Koliqit, nivelet e rrëfimit ndërtohen rrjedhshëm sa për të krijuar një thellësi diskursive. Do të thotë, del rrëfimi kryesor kur e ndjek linjën kronologjike të protagonistit, pastaj shfaqet rrëfimi i dytë ose i brendshëm si një shtresë narrative që përthekon mendimet e brendshme të personazheve, psiken, duke u fokusuar në ndjesinë dhe reflektimet, në dialogët dhe monologët e tyre. Kështu, edhe nivelet kohore në rrëfim përbëjnë një rëndësi të veçantë për strukturën e romanit, duke e pasuruar me ngjarje e kujtime të ndryshme, për ta ndërthurur me ngjarjen e rrjedhës së tanishme. Prandaj, Koliqi përdor një fokalizim të brendshëm, duke u afruar me ndjenjat dhe emocionet e personazheve kryesore. Por, kur Koliqi do që ngjarjet të dalin në mënyrë objektive, pa u ndalur në botën emocionale të personazheve, ndërthur edhe momente të një fokalizimi të jashtëm.

Strategjia diskursive e kuptimore e romanit të Koliqit thellohet përmes mjeteve letrare e figurave stilistike të përdorura në tekst, d

uke u nisur nga titulli, *Shija e bukes së mbrûme*, ku del si figurë e veprimit nacional, si figurë e atdhedashurisë, e kthimit të rrënjët. *Buka mrûme* është boshti i përqendrimit të Koliqit, Jorgjit, Djanës, Emin Dashit dhe të gjithë personazheve veprimtarë në roman, figurë e cila finalizohet krejt në fund, më dasmën e protagonistëve. Hapësira reale, Shtete e Bashkuara të Amerikës, në të cilën rrëfimi del si dëftim konotues i vendit të lirë e demokratik, atje ku mund të zhvillohen lirshëm idetë, pra vend-figurë, të cilin Koliqi e *andrron* për Shqipërinë.

Narrativa e Koliqit funksionon si një nivel i përqendruar alegorik, duke

shpërfaqur mënyra e situata të rënda, përvojat dhe ideologjitë e shqiptarëve në periudha të caktuara historike. Kështu, autori brengën e mërzinë e tij personale e mat me brengën kolektive të njerëzve tij, të shqiptarëve, andaj shpesh shpërthen edhe ironia tragjike për fatin e Shqipërisë.

Rrëfimi, po ashtu ndërlihet shumë edhe me simbolizmin si një mjet i fortë poetik, ku ngjarjet, personazhet, objektet kanë kuptime më të ngjeshura e më të thella, se sa që duken në tekst, si p.sh: *buka mrûme, dielli krenar, besa, nderi, gjakun gjenin arbnuer, bashkim vllazërimit*, etj.

Në këtë rast, strategjia rrëfimore, duke qenë element themelor i tekstit për të prodhuar kuptime e domethënie të reja, të Koliqi ekspozohet përmes fabulës klasike, ku ngjarjet ndërtohen nga rrëfimi i narratorit, veprimet e personazheve kalojnë nëpër gojën e narratorit, për të dhënë mendimin final drejt ideografisë politike.

4. *Shija dhe historia*

Në *rromanxin* e Koliqit, *shija* si titull estetik krijon një harmoni me diskursin historik. Kodi tematik ka në qendër Shqipërinë dhe në këtë rast trajtimi del më i ndërliqshëm, pasi bëhet në vend të huaj, në Amerikë. Jorgji, protagonist i veprës, përfaqëson pikëpamjet e Koliqit të cilat realizohen në veprimet e tij. Për t'i parë sa më afër Koliqin dhe Jorgjin theksojmë se të dy i përkasin një shkollimi dhe formimi; atij italian. Por, pikëpamjet e tyre prej intelektualësh përputhen krejt në fund, kur Jorgji zbulon se në shpirt i gufon poezia për dy poetët e mëdhenj të autorit, Fan Nolin dhe Gjergj Fishtën (sidomos elegjitë e Nolit për Luigj Gurakuqin dhe për Bajram Currin). Në këtë pjesë të tekstit ndodhet thelbi ideor i romanit, sepse Koliqi gjithmonë ka menduar se krahas dijes, poezia (e, sidomos poetët e përmendur nga ai) është shtrati i përgatitjeve kombëtare. Poezia për të shpreh jo vetëm gjallërinë e një kombi, por edhe të ardhmen (dimë që për Koliqin rrënjët e kombit janë në gjuhën dhe kulturën e tij). Si për Koliqin, edhe për Jorgjin, Gurakuqi dhe Bajram Curri shfaqin në mënyrë të lartë madhërinë e kombit.

Ndaj Koliqi, si dashurues i traditës shqiptare, e si vazhdues i saj, rrënjët e kulturës shqiptare i sheh te poetët e mëdhenj shqiptarë: Jeronim de Rada, Naim Frashëri e Gjergj Fishta, ku secili prej tyre zotëron nga një periudhë gjysmëshekullore të kësaj letërsie. Po ashtu, edhe nga një traditë shpirtërore e konfesionale: ortodoksizmi, islamizmi e katolicizmi. Më në fund, të tre i lidh fort ndërvete vetia themelore: shqiptarizmi (Hamiti, 2002, 576).

Pra, fund e krye, tema themelore e romanit *Shija e bukës së mbrûme* është veprimi për atdheun dhe ruajtja e autenticitetit. Ky bosht tematik dallohet në çdo faqe të librit, duke u lidhur me idenë kryesore. Porse, Koliqi, me mjeshtri trajton edhe një temë tjetër, gjendjen morale dhe shpirtërore të njeriut, e cila ka dy shkaktarë: dashurinë dhe zbrazëtinë e jetës. E para ilustruhet me Jorgjin, e dyta me Mr. Beddigtonin. Përshkrimi për këtë të

fundit bën që autori të prekë edhe një problem më ndryshe, i cili në kohën e tij nuk është trajtuar sa dhe si duhet, siç është zbrazësia shpirtërore edhe kur je i famshëm, edhe kur je i pasur. Këtu, po të vështrojmë çështjen më thellë, shohim se gjendja shpirtërore e Jorgjit dhe Mr. Beddigtonit, ndryshon. Njëri fillimisht përpiket të gjejë ekuilibrin jetësor, pastaj dashurohet dhe vuan për të, ndërsa tjetri vuan nga telashet që sjell jeta moderne.

Shija e bukës së mbrûme është një titull metonimik, por rrëfimi më shumë fokusohet drejt veprimit dhe përshkrimit të drejtpërdrejtë të realizimit të idesë. Nga ana tjetër, të gjitha personazhet janë të figurshme dhe shpalosin idetë e autorit nëpërmjet të folurit, që artikulohet si forma me e saktë e paraqitjes dhe krijimit të ngjarjes.

5. Romani i ideve

Ideja esenciale vihet në pah që në titull të romanit *Shija e bukës së mbrûme*, që bart semantikën e shijes së Shqipërisë, të njerëzve të gatuar nga një miell. Prandaj, duke e përdorur këtë si formulë, vërehet tendenca për thirrje për shpëtimin e atdheut dhe për ngritjen e tij në të gjitha planet, kulturore, politike, shëndetësore etj. Dhe, mbi të gjitha, rrëfimin e konstrukton narratori i gjithëdijshëm, meqë në tekst, kur narratori, nuk i referohet në mënyrë eksplicite vetes si personazh, kemi të bëjmë me narratorin e jashtëm (Bal, 2021, 24). Kështu që, ngjarjet janë të gjitha të parapara dhe historia e jetës shqiptare në një botë amerikane jepet shumë qartë. Kjo e pasuron këtë përshkrim edhe për faktin se Koliqi ka studiuar karakterin e njerëzve të tij, kështu që ai lehtë rrëfen jetën, dashurinë dhe misionin e tyre në një vend të huaj e të largët, siç është Amerika. Prandaj, në këtë krijim, një vend i huaj, i mbështjellë nga “shija shqiptare”, e bën autorin krijues të veçantë. Koliqi, mbi të gjitha, zgjedh Amerikën për të rrëfyer për shqiptarët që t’ua japë atë si një model që duhet të ndiqet.

Siç e theksuam në fillim, titulli i romanit e sugjeron edhe mënyrën e ndërtimit të tekstit i cili realizohet gradualisht me shpalimin e personazheve, për t’u dhënë ideja autoriale. Jorgji në roman është konstruktuar si personazh enigmatik, por shumë i vendosur, krenar e kokëfortë. Në fakt, Jorgji del dyfarësh: një herë shumë i fortë derisa nuk provohet nga dashuria, herën tjetër shumë i butë dhe i ndjeshëm kur mundet nga ajo. Për ta njohur Jorgjin dhe për t’u njohur me të ndodhurat e me personazhet, autori rrëfimin e ndërton në dy kohë: në të shkuarën dhe në të tashmen.

Libri ruan rend të rregullt fabulativ, duke përshkruar Jorgjin në kulm të dëshpërimit. Kjo gjendje e ndërlikon çështjen, pasi protagonistin provon të heqë mitin e dashurisë për Djanën me çdo metodë, por pa zgjidhje, sepse kujtimi i saj i torturon natë e ditë shpirtin, duke bërë që asgjë të mos i krijojë shije.

Koliqi, Jorgjin e paraqet si karakter më interesant, ndaj dëshmon edhe

rrëfimi se pa torturën e Djanës do të kishte rënë në një vorbull torturash dhe vuajtjesh edhe më të rënda. Paradoksalisht, fiksioni autorial na bën të mendojmë se në të kundërtën Jorgji do të vuante nga një zbrazëti shpirtërore që do t'i vinte vetiu.

Kjo pikë e fokusimit autorial, përveç që ndryshon kahun, shton dyfish efektin estetik, njëherësh duke parë si buron dashuria dhe pastaj si përshkruhet ajo. Djana me përfaqësimin e vet i jep formë dhe domethënie romanit. Ajo është figurë letrare që përcjellë idenë e autorit, fillimisht të parimit moral dhe, përfundimisht, si bartëse e “shijes së bukës” shqiptare. Tregimi i jetës së saj është shumë më i ndjeshëm (se ç’ka menduar Jorgji), por edhe më i vështirë, sepse ka një mision. Dhe, për këtë arsye ajo nuk i është përgjigjur deri në fund dashurisë së Jorgjit:

Babloku më solli para ikonave shëjte e më tha me zâ t’ulët, por të prem: ‘Dan, a e do babën t’and?’ I u përgjegja me zâ të dridhun, por me vendosmení mâ të madhe se mosha që e kishem: ‘Me shpirt!’ Ai tha, tue u vrumulisun në trup e në zëmër: ‘Athere betoju para këtyne ikonave, qi njoftën lutat e të parve të tú, se ké me dashtë vendin tand, Shqipnín, e se ké me ba në dobí të kësaj atë qi mjerisht s’mujta as nuk munde ta bâj unë...’ U betova me lot për faqe. Ai shtoi: ‘Mos harrô se ti já Dân Dada, djali i Erakli Dadës! Pres prej teje qi t’ia zbardhish faqen shtëpis e mue. Unë thojshem ‘po, po bablok’ para ikonave shëjte (Koliqi, 2003, 268).

Në çdo kënd rrëfimor dhe prapa çdo personazhi është Koliqi, duke formësuar mozaikun e tij nacional e për të theksuar gjithnjë e më fort mesazh nacional. Sensibiliteti prej poetit është një çështje tjetër e rëndësishme, që e karakterizon vijën rrëfimore të Koliqit, sidomos kur shkruhet për dashuri:

Zoja Gladys i ndieu e i pau ardhun si dy lumej me ujna të kulluet të cilët, mbas shum kohe qi rrodhen afër njani tjetri sejçili n’âmë të vet, shprazen njâni në tjetrin tue përzie në një rrymbë të valët shkumuese për m’u derdhun në fushë me turr lumnues (Koliqi, 2003, 232)

Këtu shihet sesi dashuria ngrehet shkallë-shkallë derisa arrin nivelin e njohjes. Përveç kësaj, rrëfimi dashuror koliqian kap edhe një çështje tjetër të rëndësishme, e që shpaloset përmes Jorgjit, i cili, nën gjirin e femrës, humb njësinë e kohës dhe vendit.

Në planin e tillë hetohet se edhe protagonistin nënvetëdijshtëm ka të ngulitur një kod kombëtar të sjelljes dhe të veprimit. Gradualisht po zbresim edhe te zbërthimi i çështjes bosht që vërehet më së miri duke zbuluar domethënien e dy figurave shtylla në roman, Vasil Koja dhe Erakli Doja. Dy personazhet kanë filozofinë e njëjtë të të menduarit dhe vepruarit:

lënë amanet për bijtë e tyre dashurinë ndaj vendit që Djana dhe Jorgji të realizojnë dëshirën e tyre që nuk mund ta bëjnë këta si liridashës të vjetër. Në këtë plan shohim një ndërlidhje midis fiksionit dhe faksionit të veprës së Koliqit. Tutje, sipas asaj që buron nga rrëfimi, shohim se Ernest Koliqi kalon nëpër kohët historike dhe politike për ta nxjerrë figurën e idealit kombëtar përmes një *rromanxi* të bukur. Pra, rrëfimi i disa personazheve përshtatet me gjendjen e përgjithshme dhe duke ditur edhe kontekstin e jetës së Koliqit, vepra komunikon më shumë me lexuesin.

Kështu, për të bartur zërin e esencës në roman, Koliqi rrëfimin e ndërton edhe nëpërmjet një segmenti tjetër, atë të mbledhivë të atdhedashësve shqiptarë në Amerikë, me pikë referimi problemet kombëtare. Më pastaj, Koliqi edhe krijon emrat e personazheve që merren me këtë çështje, si: Sadik Sopot, Emin Dashi (tjetër personazh prapa të cilit fshihet autori autobiografik, po edhe autoideografik), Bilo Shtërpari, Daman Griçialit, Gjini Bardhok Frisku, Jani, Theodor Spasa etj., profesionet e të cilëve janë të ndryshme, por bashkohen në mendime, duke pasur një objekt kërkimi: rrëzimin e Shqipërisë socialiste. Rrëfimi i tillë përcillet me diskutime të ndryshme, por duke mbizotëruar ideja e intelektualëve. Duhet të thuhet me këtë rast se i gjithë rrëfimi i Koliqit organizohet nëpërmjet komunikimit të personazheve për të bartur idenë autoriale të Shqipërisë socialiste, do të thotë shkombëtarizim me objektiv humbjen e qenies etnike.

Thënë shkurt, pikënisje të kësaj ideje për ndërtimin e Shqipërisë së ardhshme është dashuria që kanë për tokën e etërve dhe gjakun që lidh kujtimet e fëmijërisë. Janë, pra, të gjitha këto elemente që rrumbullakojnë idenë autoriale.

Siç e thotë edhe vetë titulli i romanit, lidhja e autorit me Shqipërinë lë gjurmë kudo në tekst dhe kurorëzohet krejt në fund, kur çdo gjë frymon shqip. E parë në këto shenja, *Shija e bukës së mbrûme*, lidh idetë në *program autorial* të veprimit në kohë të ligë për nacionin, kur Shqipëria sundohet nga ideologjia e majtë dhe diktatura e komunistëve, që në jetën shqiptare u shtrinë si utopi për ta fshirë *authentica-n* e trashëguar etnike. Një autor i rrënjëve nacionale, pra i *palcit etnik*, i *authentica-s*, si Koliqi, në këtë nyjë të jetës nacionale, thur ideologjinë dhe thotë mësimin e tij. (Shala, 2015, 100). Koliqi veprën letrare e ka konceptuar siç do të thoshte Rugova *si një tërësi estetike që në totalitetin filozofik është ekuivalente me totalitetin real. E kjo arrihet kur fenomenet e ndryshme jetësore objektivohen në një vepër* (Rugova, 2005, 27). Në këtë vështrim del që bota letrare e Koliqit, është bota reale e Shqipërisë së kohës së tij, siç thotë Kundera, se *njeriu dhe bota janë të lidhur si kërmilli me guacën e vet; bota bën pjesë te njeriu, ajo është dimension i tij, dhe njëkohësisht dhe pjesë-pjesë, që ajo ndryshon, ndryshon, gjithashtu, dhe qenia* (Kundera, 2001, 45). Intertekstualiteti te romani i Koliqit realizohet duke shfrytëzuar letërsinë orale për ta shpërfaqur

autentiken dhe etninë shqiptare, pra botën dhe frymën shqiptare me të gjitha shenjat, si dhe nëpërmjet simboleve mitike dhe historike për të shënjuar identitetet e *efekte letrare*. Kështu, Koliqi, duke përdorur këtë filozofi të gjuhës orale, e duke përdorur këto fraza idiomatike, krijon një rrëfim të ri semiotik, për të projektuar që nga fillimi ekzistencën shqiptare e për ta bërë tekstin të komunikojë me lexuesin. Këtij projekcioni shije të veçantë letrare i jep figurshmëria. Figurat ndërtojnë një *rrjet tek i cili fokusohen qenësia emocionale, formale dhe ideore* (Gros, 2011, 17). Po ashtu, Koliqi dëshiron që rrëfimet e tij në planin e sensibilitetit t'i projektojë si *libër jete* (siç thotë ai për *Lahutën e Malcís* të Fishtës), si libër që të paktën e aspiron frymën e jetës vendçe, frymën e vulës së fisit (Rrahmani, 2002, 44).

6. Pakti autobiografik

Romani i Koliqit, përveç shenjave (auto)ideografike, pra një roman që hapet ndaj ideve, qoftë autoriale, po ashtu edhe sociale, jep edhe shenja të theksueshme autobiografike, që i përgjigjen një konstrukti të nisur nga *Pasqyrat e Narcizit* (1936), e cila është më afër autobiografisë se të gjitha veprat tjera letrare të kësaj periudhe. Prandaj, Koliqi edhe në këtë roman, sprovohet si *autor autobiografik*, po ashtu edhe narrator autobiografik, duke pasur gjithashtu shenjat autobiografike si intertekst, ku modeli i jetës shfaqet si intertekst mbi të cilin ndërtohet krejt narrativa koliqiane.

Por, para se të hymë më thellë, e shohim të udhës të bëjmë një përmbledhje të nocionit të Lejeune-it për *paktin autobiografik* (*pacte autobiographique*) (Lejeune, 1975, 13), duke analizuar edhe aspekte të tjera të poetikës autobiografike, të cilat janë shtruar nga teoricienë të tjerë të shkollave të ndryshme. Lejeune-i e definoi shkrimin autobiografik duke identifikuar autorin, historinë e jetës së tij të rrëfyer në mënyrë autentike. Kështu, sipas tij del se autori autobiografik krijon të ashtuquajturin *pakt autobiografik* me lexuesin (Lejeune, Idem, 29), qoftë përmes titullit, paratekstit, shenja këto të strukturës së jashtme të tekstit, qoftë edhe në relacion me konstituesit e brendshëm tekstorë përmes të cilëve krijohet, siç e quan ai, një *pakt referencial* (*pacte référentiel*) (Lejeune, Idem, f. 36), në mënyrë që diskursi i tillë t'i referohet një realiteti jashtëtekstual. Në romanin *Shija e bukës së mbrûme*, ky pakt autobiografik ngrihet mbi referencat jashtëtekstuale dhe ato autobiografike, përmes të cilave vërehet autori-Koliqi nga një rrëfimi me shenja herë më të dukshme, herë më të fshehura autoreferenciale, të kombinuara me referenca ku jeta e tij formëson *paktin referencial* të autorit narrator dhe të *personazhit autobiografik*, siç është Emin Dashi. Ky *pakt autobiografik* përforcohet kur vihet më shumë në skenë me disa 'rekuizita' semantike Vasil Koja dhe Jorgji, të cilët krijojnë gjithashtu atë që njihet si *pakt besueshmërie* me lexuesin, duke i ofruar të dhëna që përafrohen me autorin. E, dihet se për të pasur një roman autobiografik, duhet të jetë i

qartë *identiteti i autorit*, si në rastin konkret të Koliqit, narratorit *Koliqi* dhe herë personazhi, Emin Dashi. Ky “identitet” hap probleme të shumta, si: mënyra se si mund të shpërfaqet identiteti i narratorit dhe i personazhit në tekstin e Koliqit, i cili manifestohet në formë tregimtare klasike, jo simbolike e simboliste si te *Pasqyrat e Narcizit*, ku autori është në kërkim të identitetit. Ndërsa, këtu, identiteti i autorit është i kuptueshëm dhe i qartë: autori kërkon të shpërfaqë identitetin e narratorit dhe personazhit, duke i fshehur autobiografemat e jetës së vet prapa personazhit të tij. Një rast si ky hap çështjen e identitetit dhe ngjashmërisë. Kështu, vështirësitë e takuara në këto analiza, atë e shpjen drejt të ashtuquajturës *hapësirë autobiografike* (Lejeune, Ibid) dhe kontratë të leximit. Dhe, kontrata me lexuesin përforcohet në pjesën ku autori përfshinë shenjat e jetës së tij me atë të personazhit, përmes narracionit, qoftë kur narratori i drejtohet narratorit, si te autobiografemat e mëdha të botës shqiptare, qoftë kur rrëfimi zhvendoset nga rrëfimi në perspektivë: atëherë – në tash. Pakti autobiografik përforcohet, sidomos kur referencat ngjajnë me autoreferencat e jetës së autorit, Koliqit – autor, Koliqi – intelektual, Koliqi – i mërguar. Në këtë plan, Emin Dashi, protagonist i veprës, u tha se është përfaqësues i ideografisë së Koliqit, përmes të cilit shfaqet kultura kombëtare, intelektuale dhe sociale. Në këtë portret shihen linjat autodiegrafike me referenca të narratorit-dijetar, nga idelogu i Rilindjes:

Emin Dashi e mbylli at bisedim me këto fjalë: - Ká një Zot qi mendon edhe për né. Jemi komb i vogël, i ndâm e i shperndâm: “Gjaku i ynë i shprishun”, si thoshte De Rada për të cilësue gjinden arbnore të shkapërdâme nëpër botë. Kemi mbetun mbrapa në shum pikpamje e fatet e pamëshir- shême historike na kanë zhgatrrue: Besoj se asnjë komb i vogël nuk pësoi mjerime e dhunime si ky i yni. Me gjithëkëtë habisim botën për fuqin e rre- btë qindrese qi përmbajmë në vete si komb. Të përçmuem e të rraskapitun, po, por kjo nuk na ligë- shton: duem me qënë e me qindrue Shqiptarë. (Koliqi, 2003, 295).

Përtej kësaj, ai përfaqëson edhe shkollimin dhe formimin në frymën neolatine, si letërsi kulturore, si veprim dhe edukim të njëjtë. Po ashtu, *pakti autobiografik* mbështetet fort, sidomos te personazhi mjaft kompleks dhe identitar i Koliqit, siç është Emin Dashi, një hije dhe pasqyrë e Koliqit, i cili, si atdhetar dhe model intelektual, shfaq identitetin dhe karakterin e ngjashëm me atë të autorit.

Prandaj, me të drejtë Lejeune-i konstaton se *qëllimi i teksteve me shtresime autobiografike, nuk është përngjasimi i thjeshtë, por përngjasimi ndaj të vërtetës. Jo efekti i reales, por imazhi i reales*” (Lejeune, ibid), të cilin Koliqi e përfshin me lexuesin, qoftë përmes diskursit narrativ eksplicit, qoftë përmes diskursit narrativ implicit, sidomos kur linjat fabulare kanë shtresime psikosociale. Kështu, të gjitha tekstet referenciale e detyrojnë atë që do ta quajë një *pakt referencial*, implicit apo eksplicit, në të cilin është i

përfshirë një definicion i fushës së reales dhe një deklaratë e mënyrave dhe shkallëve të përngjasimit të cilin e detyron teksti (Lejeune, idem), e të cilin romani i Koliqit ndjek shkallët e jetës së personazhit të identifikueshëm me autorin, e herë me narratorin. Madje, nevojën për një bashkëbisedues të tillë përherë e ka kërkuar poetika e zhanrit herë si *pakt autobiografik*, herë si *pakt fantazmatik*, varësisht prej statusit të tekstit. Prandaj, jo rastësisht autori konsiderohet një ndër katër instancat kryesore (Lejeune), i cili strukturon zhanrin e autobiografisë. Lejeune-i vetë e pranoi që situata e shkrimtarit autobiografik është shumë më komplekse se ajo e biografit. Në rastin e parë, çështja nuk është përngjasimi, por identiteti, që i vë në pah një sërë problemesh. Për shembull, si mund të presësh seriozisht, që një subjekt të japë pasqyrim objektiv të jetës së tij personale? Kështu, kur pakti funksionalizohet në mënyrë të hapur: jo rrallë narratori merr premisat e autorit, i cili gjithnjë ka në mendje lexuesin. Këto, më shumë se shenja të letërsisë, janë shenja të dëshmisë, meqë analepsa subjektive nga i njëjti narrator mëton të jetë analepsë objektive, rrëfim real, me synim objektivitetin dhe sinjeritetin e shkrimit përmes reminishencave të tilla, që i ndeshim te disa nga tregimet e tij si te *Tregtar flamujsh (1929)*, apo te *Hija e maleve (1935)* dhe, me theks të veçantë, te *Pasqyrat e Narcizit (1936)*, në të cilin përveç një kujtimi të turbullt, jepet edhe distanca në kohë. Kjo e fundit e zvetënon vërtetësinë, por e forcon sinjeritetin. Në këtë mënyrë, akti autobiografik kthehet në *kontratë autobiografike* (Lejeune), ndërsa aktiviteti autobiografik merr konotacione intertekstuale me jetën dhe me tekste të tjera narrative të Koliqit. Si pasojë, këto sprova autoideografike dhe autobiografike Koliqi i provon për të formësuar iluzionin e së vërtetës që rri në tëh të fiksonit.

7. Zgjerimi i formës narrative

Me format e shkurtëra tregimtare, Ernest Koliqi njihet si një nga themeluesit e prozës moderne shqipe. Ai e ka shpërfaqur këtë me një theks të veçantë që iu ka dhënë tregimeve të tij, si *novella e poemtha në prozë*, që duhet lexuar ndryshe, si në aspektin diskursiv, ashtu edhe në atë formal, por gjithmonë duke ruajtur autenticitetin e vendit. Disa prej librave të tij më të njohur, si *Hija e maleve (1929)*, *Pasqyrat e Narcizit (1936)* dhe *Tregtar flamujsh (1935)*, janë ato që i kanë dhënë Koliqit epitetin e shkrimtarit modern. Tregimet e Koliqit shquhen për rrëfime të shkurtëra, me situata e veprime të shpejta, si dhe më një stil më të dendur e të përqendruar të të shkruarit. Diskursi i tillë bën që çdo fjalë e tij të mbajë peshë më të madhe, dhe idetë t'i organizojë në mënyrë më precize dhe më të qarta. Prandaj, ky stil i Koliqit bën që te lexuesi të përçohet në mënyrë më intensive dhe efektive ideja e tërë. Format e shkurtëra të Koliqit janë "të lidhura me temat e mëdha që përthyehen në psiken-në e personës apo të rrëfimeve

psikospektive, që hapin individin nga brenda, si qenie e qeniesi, frymë e mendje. Prandaj, *psikja e mendja janë dy figura për kategoritë e mëdha të modernitetit, siç janë individi dhe mendimi, jeta e brendshme e rrjeti i ideve të tij, që bashkë bëjnë ontos-in e diskursit letrar modern* (Shala, 2015, 18).

Këto elemente, të cilat janë tërësisht të lidhura me njëri-tjetrën, mund të kishin humbur formën e dëshiruar pa fokusimin e veçantë të Koliqit në botën e qenies psikike të personazhit. Ai ka bërë një analizë të thellë të individëve, duke i trajtuar ato si probleme kryesore që rrëfehen me një ndjeshmëri të re, përmes një strukture artistike dhe një forme estetike të veçantë. Ai rrëfen duke esencjalizuar gjithçka me përpikëri, jo në formë të gjatë, por në një stil të përmbledhur, ku shfaqet menjëherë gjendja, problemi dhe zgjidhja, qoftë pozitive apo negative, duke përfunduar shpejt ngjarjen. Në këtë mënyrë, narratori futet në variante në kodin kulturor-kanunor, identitar e autobiografik, duke shenjëzuar në mënyrë implicite kuptimet dhe ndjeshmërinë që rrjedhin nga këto pika. Kjo domethënie jetësore ndriçohet nga figurat që autori zgjedh, të cilat pasqyrojnë më së miri pamjen e dhënë. Kështu, poetika e strukturimi i tregimeve të Koliqit, duke u ndërtuar nga njohja që ka autori me jetën reale zhvillohet drejt një vije që synon zbulimin e idesë autoriale. Pothuajse të gjitha personazhet mbahen të gjalla nga dëshira për të ruajtur traditën dhe për ta zbatuar kodet shqiptare e zakonore, edhe kur kjo sjell pasoja të rënda si vrasje të jetës dhe të dashurisë. Që në hyrje të librit autori e quan librin *rromanx* apo novelë e gjatë, duke shenjuar që në fillim se do të luajë me formën letrare, për dallim të formave të mëhershme. Prandaj, te kjo vepër e shohim autorin më të pjekur sa i përket aspektit krijues, poetikes, strukturimit, mendimit e ideve. Ajo që e dallon poetikën e Koliqit të romani në fjalë, është zgjerimi i strukturave narrative, nga forma e shkurtër, në formë më të gjatë, pra nga tregimet e poezitë, në roman.

Në këtë kontekst, dallimi më i mirë në mes të kalimit prej formës së shkurtër, në formën e gjatë ose anasjelltas, me tematikë të njëjtë është krahasimi i romanit në fjalë, Shija e bukes së mrûme (1960), me ciklin poetik *Bijës sime* (1964), dhe dramës *Rrâjë të lëvizin* (1965). Në dramë dhe në poezi, Koliqi krijon mundësinë që të vijë në vendlindje, në Shkodër e në shtëpi, me anë të syve të së bijës, Izës, ndërsa në roman Djana e realizon programin e tij narrativ. Por, edhe pse romani është formë letrare më e gjatë, Koliqi prapë i ndërton rrëfimet më të ngjeshura, për t'i kaluar shpejt ngjarjet me një stil të thjeshtë e të kuptueshëm, duke u përqendruar te objektiva e autorit, siç është shpalimi i ideve dhe gjendja emocionale e personazheve. Ndërsa, ajo që e karakterizon më fuqishëm romanin është që e tërë ngjarja në vepër përfundon drejt një vije të lumtur, duke u realizuar me përpikmëri çdo pjesë e tekstit, ashtu siç edhe e do kjo formë letrare, siç është *rromanxi*.

6. Përfundim

Koliqi do ta ndërtojë Shqipërinë e re, brezin e ri, e kohën e re përmes trashëgimisë së rrënjëve të vjetra, jo duke e shuar dhe zhdukur atë, por duke e jetësuar. Në këtë mënyrë, ai kërkoi e mendoi se ndërtohet e ardhmja, fryma e re nacionale shqiptare, prandaj nëpërmjet portretizimeve të ndryshme ringjall dashurinë dhe mallin për atdheun. Kjo frymë shqiptare aktualizohet përmes Djanës së romanit *Shija e bukes së mbûme*, e cila misionin e vet e kryen në Amerikë, për ta forcuar shqiptarizmin e për t'i lidhur shqiptarët bashkë kudo që janë.

I gjithë ky konceptcion artistik e kuptimor realizohet përmes shenjave autobiografike, që Koliqi krijon me raportin babë - bijë, por theksohet edhe më dukshëm kur autori qysh në *paraqitje* jep inicialet H. V., d.m.th. Hilush Vilza, pseudonim me të cilin njihet si autor. Prandaj, Hilush Vilza shfaqet me status të dyfishtë, edhe si autokomentues (për historinë e botimit të veprës), edhe si autor narrator. Pseudonimin e tij autori e ka shënuar në tekstet e veta kur ishte në mërgim, fillimisht te libri me tregime *Tregtar flamujsh*. Prandaj ky inicial i jep tekstit një mundësi tjetër interpretimi, atë të kërkimit të statusit të autorit në disa variante.

Romani *Shija e bukes së mbrûme* është i strukturuar me një fabul lineare klasike, ku Koliqi funksionalizon profesionin me pasionin artistik, herë si një narrator ekstradiegetik e homodiegetik, me ndërlidhje të thella të provave letrare dhe përvojave personale.

Bazuar në këtë që u tha më lart, Koliqi, duke përdorur forma të shkurtra narrative që përqendrohen në aspektet psikologjike dhe jetën e brendshme të individit, me *Shijen e bukes së mbrûme* (s)provohet në një gjini më të madhe dhe më të vështirë, romanin, duke modeluar e rimodeluar trajtat poetike dhe format e shkurtra tregimtare, në një megarrëfim tipik për zhanrin e gjatë dhe klasik.

BIBLIOGRAFIA

- E. KOLIQUI, *Vepra 1*, Faik Konica, Prishtinë 2003.
- E. KOLIQUI, *Vepra 2*, Faik Konica, Prishtinë 2003.
- E. KOLIQUI, *Vepra 3*, Faik Konica, Prishtinë 2003.
- E. KOLIQUI, *Vepra 4*, Faik Konica, Prishtinë 2003.
- E. KOLIQUI, *Vepra 5*, Faik Konica, Prishtinë 2003.

LITERATURA

- A. ARISTOTELI, *Poetika*, Buzuku, Prishtinë 2003.
- M. BAHTIN, *Gjuha e romanit*, në *Çështje të romanit*, Grup Autorësh, Rilindja, Prishtinë 1980.

- M. BAL, *Hyrje në teorinë narrative*, Artini, Prishtinë 2021.
- P. CHARTIER, *Hyrje në teoritë e mëdha të romanit*, Onufri, Tiranë.
- E. M. FORSTER, *Aspekte të romanit*, Parnas, Prishtinë 2017.
- N. P. GROS, *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, Prishtinë 2011.
- GRUP AUTORËSH, *Çështje të romanit*, Rilindja, Prishtinë 1980.
- GRUP AUTORËSH, *Teoria e novelës dhe e tregimit*, përgatitur nga H. Hoxha, Flaka e Vëllazërimit, Shkup 1995.
- GRUP AUTORËSH, *Teoria dhe kritika moderne*, Rozafa, Prishtinë 2008.
- S. HAMITI, *Letërisa moderne* (Vepra letrare 8), Faik Konica, Prishtinë 2002.
- E. KOLIQI, *Vepra 3*, Faik Konica, Prishtinë 2003.
- M. KUNDERA, *Arti i romanit*, Toena, Tiranë 2001.
- P. LEJEUNE, *Le pacte autobiographique* (Nouvelle édition augmentée), Seuil, Paris 1975.
- Gj. LLUKAQ, *Teoria e romanit*, Rilindja, Prishtinë 1983.
- D. LODGE, *Arti i fiksionit*, Armagedoni, Prishtinë 2023.
- T. MAN, *Estetika letrare*, në *Arti i Romanit*, përkthyer nga I. Rugova, Fondacioni Rugova, Prishtinë 2018, f. 24.
- K. RRAHMANI, *Intertekstualiteti dhe oraliteti: E. Koliqi, M. Kuteli, A. Pashku*, Prograf, Prishtinë 2002.
- J. A. RROTA, *Letërsia shqipe për shkollat të mesme*, Botime Françeskane, Shkodër 2006.
- I. RUGOVA, *Refuzimi estetik*, Faik Konica, Prishtinë 2005.
- K. M. SHALA, *Ernst Koliqi: Authentica et Urbana*, Buzuku, Prishtinë 2015.
- L. N. TOLSTOJ, *Çështje arti*, Alphabet J & H, Prishtinë 2023.
- Z. ZHENET, *Figura*, Rilindja, Prishtinë 1985.

